



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova



Komuna e Rahovecit



Plani për Mirëmbajtjen
e Hapësirave të Hapura Publike
2016-2021
Komuna e Rahovecit

**Plani për Mirëmbajtjen
e Hapësirave të Hapura Publike
2016-2021
Komuna e Rahovecit**

Ndërtimi i qyteteve gjithëpërfshirëse, të shëndetshme, funksionale, atraktive dhe produktive është ndoshta një nga sfidat më të mëdha të cilat qëndrojnë përballë njerëzimit në ditët e sotme. Pjesa më rëndësishme e enigmës për ta arritur këtë, mund të qëndrojë në hapësirat publike të cilat me të drejtë konsiderohen si zemra e zonave urbane.

Hapësirat e Hapura Publike (HHP) me një sërë funksionesh që ofrojnë ato, të projektuara mirë, të realizuara dhe të mirëmbajtura mirë, janë faktor i rëndësishëm për përfshirjen e grupeve shoqërore dhe për mirëqenien qytetare.

Falënderimet

Plani për Mirëmbajtjen dhe Plani për Investime në Hapësirat e Hapura Publike janë përgatitur nga grupi punues (GP) i komunës së Rahovecit, bartëse e të cilës është Drejtoria për Shërbime Publike në mbështetje dhe bashkëpunim të ngushtë me grupin koordinues (GK), zyrtarët e projektit si dhe konsulentët lokalë dhe ndërkombëtarë, përgjegjës të projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K).

GP dhe GK për hartimin e Planit të Mirëmbajtjes dhe Planit të Investimeve në Hapësirat e Hapura Publike në komunën e Rahovecit kanë bërë identifikimin e hapësirave të hapura publike në terren si dhe planifikimin e aktiviteteve të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre duke u bazuar në përvojën me komunat partnere lokale dhe në përvojën ndërkombëtare.

Grupi Punues

1. Muhamet Behra, DSHP – udhëheqës I grupit
2. Feim Fetoshi (ish drejtor i DSHP), DBZHR – anëtar
3. Sylejman Daka - anëtar
4. Shpejtim Mustafa - anëtar
5. Bjondina Rama - anëtar

Grupi Koordinues

1. Xhemali Haxhimustafa, nënkryetar i Komunës së Rahovecit
2. Muhamet Behra, drejtor i shërbimeve publike
3. Lulzim Sylejmani, drejtor për financa dhe buxhet

Ekipi përkrahës

1. Besnik Keka - këshilltar lokal
2. Teuta Jaha-Hoxha - zyrtare e projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation
3. Majlinda Jupolli - zyrtare e projektit DEMOS/Helvetas-Swiss Intercooperation

Lista e shkurtesave

DEMOS	Decentralization and Municipal Support / Programi për Decentralizim dhe Mbështetje Komunave
SCO-K	Swiss Cooperation Office in Kosovo / Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë
GIS	Geographical Information System / Sistemi i Informacionit Gjeografik
KKR	Kuvendi Komunal Rahovec
KR	Komuna Rahovec
HHP	Hapësirat e Hapura Publike
PMHHP	Plani i Mirëmbajtjes së Hapësirave të Hapura Publike
PIHHP	Plani i Investimeve në Hapësirat e Hapura Publike
PZhK	Plani Zhvillimor Komunal
PZhu	Plani Zhvillimor Urban
PrrU	Plani Rregullues Urban
DUPMM	Drejtoria për Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit
DSHP	Drejtoria për shërbime publike
DFB	Drejtoria për financacë dhe buxhet
DBZHR	Drejtoria për Bujqësi dhe zhvillim rural

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	7
1.1. Profili i komunës së Rahovecit	7
1.2. Funksionet e HHP-ve	7
1.3. Fushëveprimi i Planit të Mirëmbajtjes së HHP-ve	8
1.4. Parimet udhëheqëse	8
1.5. Dokumentet referuese për përgatitjen e PMHP	9
2. Gjendja aktuale dhe analiza e HHP-ve	10
2.1. Gjendja e tanishme e HHP-ve	11
2.2. Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP-ve	13
2.3. Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HHP-ve në tri vitet e kaluara.....	13
2.4. Të dhëna grafike dhe tabelore mbi HHP-të ekzistuese.....	14
2.5. Përshkrime të përgjithshme të aktiviteteve për fusha të ndryshme të mirëmbajtjes	16
3. Vizioni, objektivat dhe strategjia mbi HHP-të	17
3.1. Vizioni i Komunës së Rahovecit mbi HHP-të	17
3.2. Synimet dhe objektivat specifike	17
4. Plani Financiar	18
4.1. Nevoja për buxhet të ri për mirëmbajtje	20
4.2. Kostot e planifikuara të mirëmbajtjes së HHP-ve për periudhën 2016-2021.....	23
4.3. Rrjedha e parasë e kostove të mirëmbajtjes	24
5. Ndërgjegjësimi publik	26
5.1. Strategjia komunale dhe aktivitetet me komunitetin	26
6. Monitorimi dhe rishikimi	28
6.1. Plotësimi dhe revidimi i PMHHP	29
Shtojca 1	31
Shtojca 2	35
Shtojca 3	100
Shtojca 4	101

Lista e tabelave

Tab. 1 Analiza e sipërfaqeve për rekreacion pasiv dhe aktiv	11
Tab. 2 HHP-të pranë lapidarëve dhe pllakave përkujtimore	11
Tab. 3 Varreza të dëshmorëve dhe të martirëve	11
Tab. 4 Varrezat në zonen urbane dhe rurale	11
Tab. 5 Mirëmbajtja e HHP-ve në vitin 2013-2014.....	13
Tab. 6 Mirëmbajtja e HHP-ve në vitin 2015.....	13
Tab. 7 Lista e HHP të inventarizuara për ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes për 2016-2021 ..	14
Tab. 8 Pasqyra përmbledhëse e mirëmbajtjes vjetore të HHP-ve	19
Tab. 9 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore	20
Tab. 10 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (mujore).....	20
Tab. 11 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (tremujore)	21
Tab. 12 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (gjashtëmujore)	21
Tab. 13 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (e shprehur në vlerë)	22
Tab. 14 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore	22
Tab. 15 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (urbane e rurale).....	23
Tab. 16 Mirëmbajtja në bazë të prioriteteve	23
Tab. 17 Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve për periudhën 2016-2021	24
Tab. 18 Kostot vjetore të mirëmbajtjes së HHP-ve (në muaj)	24
Tab. 19 Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve (mujore).....	25
Tab. 20 Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve sipas tre-mujorëve	25
Tab. 21 Tabela përmbledhëse e HHP me detaje.....	33
Tab. 22 Forma tabelore e propozuar për monitorim.....	35
Tab. 23 Mirëmbajtja-Standardi i mirëmbajtjes sipas modelit 1	38
Tab. 24 Mirëmbajtja-Standardi i mirëmbajtjes sipas modelit 2	40

Lista e figurave

Fig. 1 HHP-të në zonën urbane në qendër të qytetit të Rahovecit.....	10
Fig. 2 Kostot e mirëmbajtjes në bazë të kategorive	21
Fig. 3 Pjesëmarrja e kategorive të HHP-ve.....	22
Fig. 4 Mirëmbajtja-Kostoja sipas vendbanimeve.....	23
Fig. 5 Rrjedha e parasë për vitin 2016	24

1. HYRJE

Rahoveci është komunë partnere në programin DEMOS, i financuar nga Qeveria Zvicerane gjegjësisht SCO-K (Swiss Cooperation Office in Kosovo / Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë) që implementohet nga Helvetas Swiss Intercooperation, ku ndër tjera është i orientuar edhe në mbështetje të identifikimit dhe krijimit të bazës së të dhënave të HHP-ve, krijimit dhe mirëmbajtjes së HHP-ve, vlerësimit, planifikimit, monitorimit të shërbimeve, zbatimit dhe ndërgjegjësimi publik.

1.1. Profili i komunës së Rahovecit

Territori i komunës së Rahovecit ka sipërfaqe prej 275,5 km², që shtrihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në veri kufizohet me komunën e Klinës me distance rreth 45 km, në verilindje me komunën e Malishevës rreth 16 km, në juglindje me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në jug me komunën e Prizrenit 32 km, dhe në perëndim me komunën e Gjakovës 24 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 64 km. Ekzistojnë lidhje të mira komunikuese në mes të komunave. Në jugperëndim të komunës kalon magjistralla Prizren–Pejë dhe hekurudha Prizren–Pejë.

Bazuar në regjistrimin e vitit 2011, dihet se në komunën e Rahovecit jetojnë 56.208 banorë. Dendësia e popullsisë në komunën e Rahovecit është afërsisht 204 banorë në 1 km², ku 56.208 banorë jetojnë në një sipërfaqe prej 275,5 km². Kjo është një dendësi relativisht e lartë e popullsisë, e cila është më e larta nëse krahasohet me dendësinë e popullsisë në Kosovë.

Në Komunën e Rahovecit gjenden 35 vendbanime dhe një qendër urbane. Territori i komunës së Rahovecit ndahet në 35 zona kadastrale, përderisa në një zonë kadastrale gjendet një vendbanim, me përjashtim të Saroshit, i cili gjendet në zonën kadastrale të vendbanimit të Çifllakut.

Organizimi administrativ i komunës së Rahovecit është i bazuar në 8 qendra komunale dhe një qendër lokale. Rrugët urbane janë 30,6 ose 10,3% nga totali i përgjithshëm i rrugëve prej 751 km.

1.2. Funksionet e HHP-ve

- Përjetim i natyrës: një mundësi për qytetarët që të përjetojnë mjediset e pasura dhe natyrore, kulturore, arkeologjike, etj.;
- Rekreacion: ofrim i mundësive të llojllojshme për rekreacion në mjedise natyrore; ecje, vrapim, çiklizëm, tubime shoqërore, ngjarje kulturore;
- Edukim: HHP-të mund të shërbejnë edhe si klasa natyrore me mundësi mësimi dhe hulumtimi me nxënës dhe fëmijë të grupmoshave të ndryshme;
- Projektim urban: mjediset përgjatë HHP-ve karakterizohen me kufizime në zhvillimet ndërtimore dhe ofrojnë peizazhe dhe vizura të mira, definojnë kufijtë urban, si dhe dekurajojnë zgjerimet e pakontrolluara urbane;
- Krijim i trashëgimisë: ruajtja e tipareve të rëndësishme të mjedisit natyror të qytetit të Rahovecit është prioritet i lartë për qytetarët dhe për ambiciet programore lidhur me shtretërit e lumenjve,

korridoret e gjelbra, ato hekurudhore, rrugore, etj.;

- Organizime kulturore, edukim i publikut për ruajtjen e natyrës, ambientit dhe ngritjen e ndërgjegjes qytetare;
- Funksione rregulluese klimatike, ruajtja e llojlojshmërisë së florës dhe faunës, balancim i CO₂, motivim dhe inspirim për kulturë, art, etj.

1.3. Fushëveprimi i Planit të Mirëmbajtjes së HHP-ve

Me Hapësira të Hapura Publike (HHP) të përfshira në këtë plan nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rëndësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Rahovecit, si: parket, sheshet, hapësirat për parkim automjetesh, trotualet, varrezat dhe hapësirat përreth objekteve sakrale dhe monumentale, përfshirë ndriçimin publik brenda tyre.

Qëllimi i Planit të Mirëmbajtjes (PM) është që qartas t'i definojë nevojat/kërkesat dhe veprimet e qeverisjes lokale dhe drejtorive gjegjëse komunale për t'i mirëmbajtur HHP-të në një nivel standard të dëshirueshëm. Ai është i menduar që ta mundësojë identifikimin, justifikimin dhe definimin e prioritetëve të nevojshme për mirëmbajtjen e HHP-ve.

Plani është i hartuar për periudhën afatmesme 2016-2021, është i përmirësueshëm dhe mund të plotësohet e të përditësohet për çdo vit dhe në baza empirike pas analizës së realizimit të tij në vitin paraprak

1.4. Parimet udhëheqëse

Këtu më poshtë janë përmendur disa nga parimet udhëheqëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e HHP-ve si procese ligjore dhe të planifikimit të komunitetit bazuar në strategjinë mbi HHP-të si pjesë vitale e kornizës së zhvillimit lokal, me qëllim të përmirësimit dhe ruajtjes së karakterit të hapësirave në të cilat qytetarët jetojnë, veprojnë dhe kalojnë kohën e tyre të lirë.

- Mirëmbajtja e të gjitha HHP-ve në gjendje të mirë dhe funksionale;
- Shpërndarja e njëtrajtshme e HHP-ve në të gjitha vendbanimet, qofshin ato formale apo joformale;
- Adresimi i drejtë i të gjitha çështjeve projektuese dhe operative lidhur me nevojat për mirëmbajtjen e HHP-ve;
- Standardizimi i mirëmbajtjes së rregullt. Në të ardhmen e afërt mund pritët që të vendoset një sistem relativisht i normalizuar dhe i njëjti të adaptohet qoftë për planifikim, për rishikim të kërkesave plotësuese në mirëmbajtje apo për zhvillimin e hapësirave të reja publike.

Zonat/fushat e mirëmbajtjes së HHP-ve të rekomanduara për standardizim në këtë dhe në dokumentet e përditësuara deri në normalizimin e pritët gjatë cikleve të ardhshme të projektit:

- Mirëmbajtja e gjelbërimit (të ulët, të mesëm, të lartë);
- Mirëmbajtja e ambienteve të ndërtuara (sheshe, shtigje për këmbëesorë dhe sipërfaqe të shtrura);
- Mirëmbajtja e hapësirave për parkim automjetesh;

- Mirëmbajtja e rrethojave të HHP-ve;
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve;
- Mirëmbajtja e varrezave.

Përshkrime standarde në formë të specifikimeve teknike për fusha të ndryshme të mirëmbajtjes së HHP-ve janë pjesë përbërëse e këtij dokumenti (Shtojca).

Për shkak të gjendjes aktuale jo të mirë, planifikimi për riparime kapitale është i përfshirë në planin e investimeve dhe është dokument që i paraprirë planit të mirëmbajtjes dhe i njëjti është përpiluar pas incizimit në detaje të gjendjes aktuale të HHP-ve në qytet.

1.5. Dokumentet referuese për përgatitjen e PMHP

Parimet bazohen në dokumentet e hartuara edhe të planifikuara në parimet e mundësisë së shumë llojshmërisë së shfrytëzimit. Komuna e Rahovecit e ka të miratuar Planin Zhvillimor Komunal, si dhe është në proces Planit Rregullues i hollësishëm për “Qendrën e Vjetër të Qytetit”. Disa nga dokumentet në kuadër të kornizës ligjore në të cilat është referuar përgatitja e këtij plani:

- Plani Zhvillimor Komunal (PZHK), i miratuar në vitin 2013;
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e RK / Prishtinë: viti III / Nr. 28 / 04 qershor 2008, Neni 17, paragrafi p, Ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike;
- Ligji Nr. 04/L174 për Planifikimin Hapësinor;
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit ;
- Rregullorja për shërbime komunale dhe emergjencë 01 Nr. 1676 të datës 30.03.2012;
- Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit me 01 Nr. 239 të datës 30.01.2015.

2. GJENDJA AKTUALE DHE ANALIZA E HHP-VE

Më poshtë është paraqitur një pjesë e hartës së qytetit, zona e ngushtë e qendrës ku HHP-të ekzistuese kryesisht janë të grupuara.

Rezultatet e këtij inventarizimi të detajuar janë paraqitur në hartat tematike të krijuara në QGIS si dhe në formë tabelore (aneks), të punuara gjatë sesioneve të rregullta me konsulentët të programit DEMOS. Në të njëjtat janë paraqitur HHP-të me veçoritë sipas tipologjisë, madhësisë, kualitetit, si dhe sipas frekuentimit nga ana e qytetarëve.




Fig. 1 HHP-të në zonën urbane në qendër të qytetit të Rahovecit

2.1. Gjendja e tanishme e HHP-ve

Një inspektim në detaje është ndërmarrë nga ana e grupit punues për të evidentuar dhe përditësuar inventarin e HHP-ve, për t'i matur sipërfaqet, si dhe për ta vlerësuar gjendjen aktuale të tyre në komunën e Rahovecit. Kjo ishte faza e parë e vlerësimit sistematik, promovimit dhe zhvillimit të Hapësirave të hapura publike në zonën urbane të qytetit.

Rezultatet e këtij inventarizimi të detajuar janë paraqitur në hartat tematike të krijuara në QGIS si dhe në formë tabelore (shtojca 1 dhe 2 në këtë dokument), të punuara gjatë sesioneve të rregullta me konsulentët e programit DEMOS. Në të njëjtat janë paraqitur HHP-të me atributet sipas tipologjisë, madhësisë, kualitetit, si dhe sipas frekuentimit nga ana e qytetarëve.

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve

Sa i përket sipërfaqeve aktuale të HHP-ve në qytetin e Rahovecit, nga inventarizimi i sipërpërmendur janë marrë të dhëna mbi sipërfaqet e hapësirave në raport me numrin e banorëve, të cilat janë treguar në tabelat në vijim.

Tab. 1 Analiza e sipërfaqeve për rekreacion pasiv dhe aktiv

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m ²	Nr. i banorëve	Sip. e HHP-ve në m ² / ban.
Parqe/gjelbërime	6.944	56.208	0,12
Sheshe	865	56.208	0,01
Shëtitore pranë lumit	3.100	56.208	0,05
Gjithsej HHP në m ²	10.909	56.208	0,19

Tab. 2 HHP-të pranë lapidarëve dhe pllakave përkujtimore

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m ²
HHP-të pranë lapidarëve	44
HHP-të pranë pllakave përkujtimore	4.552
	4.596

Tab. 3 Varreza të dëshmorëve dhe të martirëve

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m ²
Varreza të dëshmorëve	7.528
Varreza të martirëve	4.750
Gjithsej në m ²	12.278

Tab. 4 Varrezat në zonën urbane dhe rurale

HHP-të sipas tipologjisë	Sipërfaqja në m ²
Varreza në zonën urbane	99.921,5
Varreza në zonën rurale	147.997
Gjithsej në m ²	247.918,5

Sipërfaqe të ndërtuara dhe të tjera të cilat nuk janë trajtuar në plan dhe të cilat duhet të plotësohen në revidimin e planit janë:

- Terrenet sportive;
- Shtigjet për këmbësorë;
- Parkingjet;
- Tregjet e gjelbra.

Nga tabelat më lart, është evidente se standardet lokale ekzistuese nuk përkojnë me ato projektuese dhe të synuara për HHP (sheshe, parqe dhe rekreacion), ndërsa gjendja e tanishme në përgjithësi mund të përshkruhet si në vijim:

- Sipërfaqja aktuale e HHP-ve për rekreacion aktiv dhe pasiv është 0,19 m²/banorë.
- Gjendja aktuale (vendndodhja e HHP-ve) në aspektin e qasjes, me fokus në largësinë (distançë – kohë); megjithëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në aspektin e rrezes së mbulimit me HHP, nga vërtetimet e përgjithshme është e qartë se hapësirat ekzistuese në përgjithësi janë të koncentruara në qendër. Ato nuk mbulojnë zonat urbane larg qendrës së qytetit.
- Në këtë moment nuk mund të pohohet se ato vërtetë janë të mjaftueshme dhe të ndërlidhura mirë, mirëpo është synim i komunës së Rahovecit që në një plan afatgjatë të ofrojë të njëjtat në një nivel standard të dëshirueshëm.

Standardet e synuara/të parapara në planet komunale janë adaptuar edhe në PMHP; qeveria komunale synon të ofrojë HHP për rekreacion aktiv dhe pasiv në numër dhe sasi të mjaftueshme për t'i plotësuar nevojat me përmbajtje natyrore, sheshe, shtigje, hapësira të tjera të shpërndara në aspektin hapësinor, ashtu që ato të jenë afër qytetarëve. Standardi i synuar kuantitativ i HHP-ve në plan afatgjatë është 7-10 m²/banorë.

Cilësia e HHP-ve ekzistuese

Standardet kualitative; HHP-të kualitative promovojnë ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor. Mundësia për aktivitete fizike, qofshin ato aktive apo pasive, për pjesëmarrësit do të jetë e dobishme si në aspektin fizik, shoqëror dhe psikologjik, duke rezultuar në reduktim të tensionit - stresit të përditshëm, në promovimin e jetës së shëndoshë të qytetarëve si dhe në stabilitetin e lagjeve.

Është vlerësim i përgjithshëm se në mungesë të një plani adekuat por edhe të kapaciteteve buxhetore të kufizuara, HHP-të në të kaluarën nuk janë mirëmbajtur në nivel të duhur.

Shfrytëzimi i HHP-ve ekzistuese

Sipas përdorimit, HHP-të në përgjithësi janë klasifikuar në ato me përdorim të shpeshtë, si parqet dhe hapësirat gjelbëruese në zonën e ngushtë të qendrës, me shfrytëzim mesatar, dhe HHP të cilat nuk përdoren fare.

2.2. Kontratat aktuale për menaxhimin e HHP-ve

Në të kaluarën si edhe tani, mirëmbajtja e HHP-ve është bërë me kontrata shërbimesh të dhëna operatorëve të kontraktuar nga jashtë, gjegjësisht, kontrata kornizë me afat trevjeçar.

Të njëjtat menaxhohen nga zyrtari i angazhuar për mbikëqyrjen e projekteve të infrastrukturës. Nga defektet e shumta të identifikuar në to, mund të përmenden:

- a. mangësi në ndarjen e zonave/fushave të mirëmbajtjes;
- b. mangësi në aktivitetet e parapara të mirëmbajtjes;
- c. përkrahje jokoncize të aktiviteteve të mirëmbajtjes;
- d. mungesë e specifikimeve teknike;
- e. mangësi në planifikim dhe në dinamikë të mirëmbajtjes, etj.

Mangësitë e përmendura më lart kanë vënë në pyetje edhe relevanten e çmimeve të ofertuar në kontratat e mëhershme, ndërsa si pasojë, edhe monitorimi i mirëmbajtjes ka mundur të jetë i vështirësuar.

2.3. Shpenzimet operative për mirëmbajtjen e HHP-ve në tri vitet e kaluara

Nga analiza e kontratave të mëhershme, të dhënat mbi çmimet njësi për mirëmbajtjen e HHP-ve janë paraqitur në tabelën në vijim:

Tab. 5 Mirëmbajtja e HHP-ve në vitin 2013-2014

HHP-të sipas tipologjisë	Njësia / m ²	Çmimi njësi mes. €/m ²	Çmimi i mirëmbajtjes së HHP-ve
Parqe dhe H. gjelbëruese	4.917,5	/	/
Sheshe	120	/	/
Shëtitore dhe shtrat i lumit	1,878	/	/
Sipërfaqe me drurende	655	/	/
HHP pranë pllakave përkujtimore, shtatoreve dhe komplekseve memoriale	5.202,45	/	/
Varreza	9.479	/	/
Gjithsej për mirëmbajtjen e HHP-ve (vlera e kontratës)			16.231,15 euro

Tab. 6 Mirëmbajtja e HHP-ve në vitin 2015

HHP-të sipas tipologjisë	Njësia / m ²	Çmimi njësi mes. €/m ²	Çmimi i mirëmbajtjes së HHP-ve
Parqe dhe H. gjelbëruese	4.917,5	0,50 €	2.455,20 €
Sheshe	120	0,40 €	48,00 €
Shëtitore dhe shtrat i lumit	1.878	0,40 €	751,20 €
Sipërfaqe me drurende	655	0,40 €	262,00 €
HHP pranë pllakave përkujtimore, shtatoreve dhe komplekseve memoriale	5.202,45	0,65 €	3.363,07 €
Varreza	9.479	0,60 €	5.687,40 €
Gjithsej për mirëmbajtjen e HHP-ve (vlera e kontratës)			14.090,07 €

2.4. Të dhëna grafike dhe tabelore mbi HHP-të ekzistuese

Të dhënat tabelore nga planifikimi i mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike (HHP) për tipologjitë e caktuara në periudhën afatmesme 2016-2021 janë dhënë në tabelën në vijim:

Tab. 7 Lista e HHP të inventarizuara për ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes për 2016-2021

Nr.	ID	Emri	Prioriteti	Zona	Kategoria
1	2	Parku dhe sip. gjelbëruese te rrethi në qendër	Prioritet i lartë	Urbane	Park
2	38	Parku te ndërtesat te KEK-u, tek semaforët	Prioritet i lartë	Urbane	Park
3	41	Parku në qendër të Fortesës	Prioritet i lartë	Rurale	Park
4	42	Parku në qendër të Xërxës	Prioritet i lartë	Rurale	Park
5	55	Parku në qendër të Drenocit	Prioritet i lartë	Rurale	Park
6	56	Parku në Palluzhë	Prioritet i lartë	Rurale	Park
7	3	Rrethi në hyrje të qytetit	Prioritet i lartë	Urbane	Gjelbërim
8	39	Maja e Shkodranit	Prioritet i lartë	Urbane	Gjelbërim
9	40	Rrethi në Apterushë	Prioritet i lartë	Rurale	Gjelbërim
10	43	Rrethi në Krushë të Madhe	Prioritet i lartë	Rurale	Gjelbërim
11	45	Gjelbërimi te shkolla "4 Dëshmorët" në Ratkoc	Prioritet i lartë	Rurale	Gjelbërim
12	46	Gjelbërimi në rrugën "Xhelal Hajda-Toni"	Prioritet i lartë	Urbane	Gjelbërim
13	47	Gjelbërimi në rrugën "Xhevat Kasapi"	Prioritet i lartë	Urbane	Gjelbërim
14	48	Gjelbërimi në rrugën "Avdullah Bugari"	Prioritet i lartë	Urbane	Gjelbërim
15	53	Gjelbërimi në rrugën "Xhelal Hajda-Toni" te Komuna	Prioritet i lartë	Urbane	Gjelbërim
16	54	Sheshi tek Vrella në qendër	Prioritet i lartë	Urbane	Shesh
17	66	Sheshi "Mbretëresha Teutë"	Prioritet i lartë	Urbane	Shesh
18	67	Mirëmbajtja e Duhllos	Prioritet i ultë	Rurale	Shtrat lumi
19	68	Mirëmbajtja e Rimnikut në Fortesë	Prioritet i ultë	Rurale	Shtrat lumi
20	50	Mirëmbajtja e lumit në Ratkoc	Prioritet i ultë	Rurale	Shtrat lumi
21	51	Lapidari i dëshmorëve Visar Hoti dhe Safet Latifi	Prioritet i mesëm	Urbane	HHP pranë lapidarit
22	4	Lapidari i dëshmorëve në rrugën Fortesë-Celinë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë lapidarit
23	5	Pllaka përkujtimore te "Kroi i Haxhisë"	Prioritet i mesëm	Urbane	HHP pranë pllakës përkujtimore
24	6	Pllaka përkujtimore e dëshmorit Agim Qelaj	Prioritet i mesëm	Urbane	HHP pranë pllakës përkujtimore
25	8	Pllaka përkujtimore te "Qëndresa"	Prioritet i mesëm	Urbane	HHP pranë pllakës përkujtimore
26	9	Pllaka përkujtimore në Hamovc	Prioritet i mesëm	Urbane	HHP pranë pllakës përkujtimore
27	10	Pllaka përkujtimore e Tonic dhe Micit në Apterushë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
28	12	Pllaka përkujtimore te shkolla në Gexhë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
29	13	Pllaka përkujtimore te shkolla në Malësi të Vogël	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
30	19	Pllaka përkujtimore te B. Bekteshi Apterushë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
31	20	Pllaka përkujtimore në Dabidol	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore

32	22	Pllaka përkujtimore në Palluzhë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
33	24	Pllaka përkujtimore te sholla në Drenoc	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
34	25	Pllaka përkujtimore “Bedrush Gashi” Drenoc	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
35	28	Pllaka përkujtimore “Dëshmorët e 90” në Brestoc	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
36	30	Pllaka përkujtimore e dëshmorëve në Hoqë të Vogël	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
37	31	Pllaka përkujtimore në kodër të fshatit në Nagac	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
38	32	Pllaka përkujtimore në kodër të f. në Krushë të Madhe	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
39	33	Pllaka përkujtimore në kodër të fshatit në Krushë të Madhe - Ragip Hoti	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
40	35	Pllaka përkujtimore në kodër të Zatriqit	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
41	36	Pllaka përkujtimore e dëshmorit Sakip Bellaqa në Fortesë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
42	37	Pllaka përkujtimore e dëshmorit Gani Paqarizi në Fortesë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
43	49	Pllaka përkujtimore e dëshmorit Milaim Krasniqi	Prioritet i mesëm	Urbane	HHP pranë pllakës përkujtimore
44	52	Pllaka përkujtimore te shkolla në Denjë	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
45	58	Pllaka përkujtimore Fortesë-Pataqan	Prioritet i mesëm	Rurale	HHP pranë pllakës përkujtimore
46	59	Varrezat e qytetit të Rahovecit - varrezat ortodokse	Prioritet i ultë	Urbane	Varrezë
47	60	Varrezat në Drenoc	Prioritet i ultë	Rurale	Varrezë
48	61	Varrezat e Berishëve në Drenoc	Prioritet i ultë	Rurale	Varrezë
49	62	Varrezat në Ratkoc	Prioritet i ultë	Rurale	Varrezë
50	63	Varrezat në Krushë të Madhe I	Prioritet i ultë	Rurale	Varrezë
51	64	Varrezat në Xërxë	Prioritet i ultë	Rurale	Varrezë
52	57	Varrezat në Fortesë	Prioritet i ultë	Rurale	Varrezë
53	7	Varrezat e qytetit të Rahovecit - varrezat myslimane	Prioritet i ultë	Urbane	Varrezë
54	11	Varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Rahovec	Prioritet i lartë	Urbane	Varrezë e dëshmorëve
55	14	Varrezat e dëshmorëve në Reti të Epërme	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
56	15	Varrezat e dëshmorëve në Apterushë	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
57	16	Kompleksi te shkolla “4 Dëshmorët” në Ratkoc	Prioritet i lartë	Rurale	Varreze e dëshmorëve
58	17	Varrezat e dëshmorëve në Ratkoc	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
59	18	Varrezat e dëshmorëve në Denjë	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve

60	21	Varrezat e martirëve në Denjë	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
61	23	Varrezat e martirëve në Pastasel	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
62	26	Varri i dëshmorit Milaim Krasniqi në Pastasel	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
63	27	Varrezat e martirëve në Hoqë të Vogël	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
64	29	Varrezat e martirëve në Brestoc	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
65	34	Varrezat e dëshmorëve te xhamia në Nagac	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
66	44	Varrezat e martirëve dhe varrezat në Celinë	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
67	65	Varri i dëshmorit në Senoc	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e dëshmorëve
68	69	Kompleksi memorial në Krushë të Madhe	Prioritet i lartë	Rurale	Varrezë e martirëve
69	70	Pllaka përkujtimore në Nagac – afër shkollës	Prioritet i mesëm	Rurale	Pllakë përkujtimore
70	1	Hapësira skaj mali në Nagac	Prioritet i mesëm	Rurale	Park

2.5. Përshkrime të përgjithshme të aktiviteteve për fusha të ndryshme të mirëmbajtjes

- a. Në aktivitetet e pastrimit përfshihen: grumbullimi dhe largimi i mbeturinave dhe gjetheve, pastrimi i kanaleve të kullimit, pastrimi e grafitëve, i shtigjeve dhe sipërfaqeve të ndërtuara (me kubëza betoni, asfalt, beton, fontana, vepra arti, etj).
- b. Në aktivitetet e hortikulturës përfshihen: ujitja, kositja, mbjellja, plehërimi, ajrosja, dezinfektimi, mirëmbajtja e gjelbërimit të ulët, të mesëm, të lartë, etj.
- c. Në aktivitetet e mirëmbajtjes së ambientit të ndërtuar në kuadër të HHP-ve janë: mirëmbajtje/ riparime të vogla në shtigje, sipërfaqe të ndërtuara, mobilieri urbane, kënde për lojëra fëmijësh, fontana, sisteme të ujitjes, mirëmbajtje për skulptura dhe vepra të tjera arti, mirëmbajtje e ndriçimit publik, etj.

3. VIZIONI, OBJEKTIVAT DHE STRATEGJIA MBI HHP-TË

3.1. Vizioni i Komunës së Rahovecit mbi HHP-të

Vizioni për komunën e Rahovecit është i përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal si dhe në Planet Zhvillimore Komunale dhe Urbane. I njëjti përcakton pritshmëritë në terma afatgjatë për qytetin në shumë fusha të rëndësishme zhvillimore, njëra nga të cilat është edhe ajo e HHP-ve për të cilat gjithashtu parashihet një vizion i synuar të arrihet sipas strategjisë gjegjëse edhe në kuadër të PZhK; *“Qendër me vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore dhe sigurim i ambientit të qëndrueshëm urban”*.

Në mënyrë që të ofrojë vizionin për HHP-të në komunën e Rahovecit, grupi punues në konsultim me grupin koordinues si dhe me grupe qytetarësh, në debate publike ka zhvilluar objektivat e përgjithshme në vijim si dhe strategjinë për arritjen e tyre:

- i. Të ofrojë hapësira publike me qasje të mirë, të ndërlidhura mirë, shumëfunktionale dhe të dallueshme/identifikuese.
- ii. Të menaxhojë me kualitetin e HHP-ve në mënyrë që të sigurojë që ato të jenë tërheqëse dhe të sigurta për të gjithë shfrytëzuesit.
- iii. Të mbështesë dhe të promovojë në mënyrë aktive partneritetin publiko-privat dhe përfshirjen e komunitetit. Mbështetja dhe partneriteti si nga aspekti i vetëdijesimit, ruajtja e HHP-ve ashtu edhe pjesëmarrja aktive dhe konsultimi i qytetarëve në planifikim të HHP-ve të reja në përputhshmëri me nevojat e komunitetit – *(kërkesë nga debati publik i përmendur më lart)*.

3.2. Synimet dhe objektivat specifike

Synimi 1 – Ngritja e cilësisë së HHP-ve ekzistuese

- Objektivi 1: Ngritja e nivelit të mirëmbajtjes dhe përmirësimi i cilësisë së HHP-ve në periudhën afatmesme 2016 – 2021 nëpërmjet zbatimit të planit të hartuar.

Synimi 2 – Promovimi i HHP-ve

- Objektivi 1: Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e HHP-ve në periudhën afatmesme 2016-2021.

Synimi 3 - Rigjallërimi HHP-ve ekzistuese

- Objektivi 1: Deri në fund të vitit 2016, të rigjallërohen 3.000 m² parqe ekzistuese;
- Objektivi 2: Deri në fund të vitit 2017, të rigjallërohen 5.000 m² parqe ekzistues;
- Objektivi 3: Deri në vitin 2021, të rigjallërohen rreth 20.000 m² parqe dhe hapësira gjelbëruese.

Synimi 4 - Investimet në HHP-të e reja

- Objektivi 1: Deri në vitin 2021 do të krijohen korridore të gjelbra me rreth 1.300 copë drurë të mbjellë përgjatë trotuareve dhe hapësirave përreth.

- Objektivi 2: Krijimi i HHP-ve të reja me sipërfaqe rreth 15.000 m² deri në vitin 2018, të cilat do të kontribuonin në rritjen e standardit sasior me 1,2 m²/ban. dhe atë në rrugët si:
 - Rruga “28 Nëntori”;
 - Rruga “28 Nëntori II”;
 - Rruga “Gëzim Hamza I”;
 - Rruga “Gëzim Hamza II”;
 - Rruga “Mizair Isma”;
 - Trotuaret tek “Rruga e UÇK-së I”;
 - Trotuaret tek “Rruga e UÇK-së II”.

4. PLANI FINANCIAR

Plani vjetor i mirëmbajtjes është i bazuar në planifikimet aktuale buxhetore të komunës së Rahovecit, me synim të përmirësimit të cilësisë së HHP-ve. Pikënisja e Planit Financiar është të mundësohet mbulimi i kostove të mirëmbajtjes për aktivitetet e planifikuara vjetore të mirëmbajtjes. Plani për mirëmbajtjen për periudhën e planit 2016-2021 përfshin të gjitha hapësirat publike ekzistuese po ashtu edhe të gjitha kostot e mirëmbajtjes së HHP-ve të cilat do të ndërtohen si pjesë e Planit Investiv për periudhën 2016-2021.

Në vitin 2016 gjithësej janë inventarizuar shtatëdhjet (70) Hapësira të hapura publike në territorin e komunës së Rahovecit, ku vlera e përlogaritur e kostove vjetore e hapësirave të mirëmbajtura është 25.130 euro ndërsa vlera mesatare mujore e kostove të mirëmbajtjes është 2.094 euro.

Në kuader të HHP kemi:

- **Ambienti i ndërtuar:** kosto e mirëmbajtjes është në vlerë prej 6.129 euro (24,4% prej totalit të kostove vjetore);
- **Aktivitetet e pastrimit:** kosto e mirëmbajtjes është në vlerë prej 13.330 euro (53% prej totalit të kostove vjetore);
- **Aktivitetet e hortikulturës:** kosto e mirëmbajtjes është në vlerë prej 5.675 euro (22,6% prej totalit të kostove vjetore).

Tab. 8 Pasqyra përmbledhëse e mirëmbajtjes vjetore të HHP-ve

Numri i Hapësirave **68**
Vlera e vjetore e mirëmbajtjes **25,130**
Vlera e mesatare mujore e mirëmbajtjes **2,094.15**

Ndarja e mirëmbajtjes ne kategori	Euro	Në % Euro	Ne/ m ²	Në % Ne/ m ²	Nr.HHP
Shesh	9,143	36.4%	1,522,810	96.6%	10
Gjelbërim	2,669	10.6%	7,800	0.5%	9
Lumenjtë	706	2.8%	-	0.0%	3
Park	3,784	15.1%	9,211	0.6%	6
Varreze e Dëshmoreve	3,227	12.8%	16,126	1.0%	14
Varreze e martireve	1,316	5.2%	7,679	0.5%	1
HHP-Pllaka Përkujtimore	4,090	16.3%	12,793	0.8%	23
HHP-Lapidaret	196	0.8%	82	0.0%	2
Total	25,130	100.0%	1,576,501	100.0%	68

Kategoria	Total	Ne %
AN-Ambienti i ndërtuar	6,124	24.4%
AP-Aktivitetet e Pastrimit	13,330	53.0%
H-Aktivitetet e Hortikulturës	5,675	22.6%
Total	25,130	100.0%

Prioriteti	Euro	Numri i HHP
Prioritet i lartë	8,260	31
Prioritet i mesëm	4,286	25
Prioritet i ultë	12,583	12
Total	25,129	68

Kategoria	Urbane	Rurale	Total
Gjelbërim	2,409	260	2,669
HHP-Lapidaret	79	116	196
HHP-Pllaka Përkujtimore	1,058	3,033	4,090
Lumenjtë	-	706	706
Park	832	484	1,316
Shesh	4,502	4,641	9,143
Varreze e Dëshmoreve	962	2,821	3,784
Varreze e martireve	-	3,227	3,227
Total	9,842	15,288	25,130

Ne % **39.2%** **60.8%** **100.0%**

Kategoria	Q1	Q2	Q3	Q4	Total
Shesh	1,374	6,131	1,608	30	9,143
HHP-Pllaka Përkujtimore	1,109	2,372	578	31	4,090
Varreze e Dëshmoreve	562	2,320	758	144	3,784
Varreze e martireve	928	1,801	455	43	3,227
Gjelbërim	1,332	999	317	20	2,668
Park	502	636	173	5	1,316
Lumenjtë	-	706	-	-	706
HHP-Lapidaret	18	166	12	-	196
Total	5,825	15,130	3,900	273	25,129

4.1. Nevoja për buxhet të ri për mirëmbajtje

Kostot e mirëmbajtjes së HHP-ve janë të bazuara në aktivitete të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre. Të gjitha hapësirat janë të vlerësuara individualisht, me të gjitha veçoritë e hapësirave, duke aplikuar kostimin e të gjithë faktorëve me ndikim në mirëmbajtje.

Për planifikimin e kostove të mirëmbajtjes janë përcaktuar në tri grupe të kostove, të cilat mundësojnë njohjen dhe kontrollin e kostove të HHP-ve.

Kostot e bazuara në grupe janë:

- AN - Ambienti i ndërtuar;
- AP - Aktivitetet e pastrimit ;
- AH - Aktivitetet e hortikulturës.

Tab. 9 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore

Kategoria	Totali	Në %
AN - Ambienti i ndërtuar	6.124	24,4%
AP - Aktivitetet e pastrimit	13.330	53,0%
AH - Aktivitetet e hortikulturës	5.675	22,6%
Totali	25.129	100%

Tab. 10 Mirëmbajtja në bazë të kategorieve kryesore (muajore)

Kategoria	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali	%
AN	0	0	724	2284	149	1207	140	727	679	175	37	3	6,124.16	24.4
AP	0	0	2979	5588	1481	1058	1155	776	244	30	18	0	13329.56	53
AH	0	0	2123	327	1527	1509	0	82	97	10	0	0	5675.12	22.6
Totali	0	0	5825	8198	3158	3774	1295	1585	1020	216	55	3	25129	100
%	0	0	23.2	32.6	12.6	15	5.2	6.3	4.1	0.9	0.2	0%	100%	

Kostot e mirëmbajtjes të bazuara në muaj ofrojnë informacione të një shpërndarje të kostove në bazë të kategorive kane efektet e sezonalitetit, ne veçanti grupi i kostove të mirëmbajtjes së hortikulturës.

- **Tremujori i parë:** 5.825 euro, e shprehur në përqindje të vlerës totale të shpenzimeve vjetore 23,2%;
- **Tremujori i dytë:** 15.130 euro, e shprehur në përqindje të vlerës totale të shpenzimeve vjetore 60,2%;
- **Tremujori i tretë:** 3.900 euro, e shprehur në përqindje të vlerës totale të shpenzimeve vjetore 15,5%;
- **Tremujori i katërt:** 273 euro, e shprehur në përqindje të vlerës totale të shpenzimeve vjetore 1,1%.

Analiza e kostove të mirëmbajtjes në bazë të tremujorëve është e përqendruar në periudhat e tremujorit të parë dhe tremujorit të dytë të vitit. Vlera e kostove për këtë periudhë është 20.995 euro, ose e shprehur në përqindje 83,4 % nga kostot e përgjithshme në nivel vjetor.

Tab. 11 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (tremujore)

Kategoria	TM1/2016	TM2/2016	TM3/2016	TM4/2016	Totali	%
AN-Aktivitetet e ndërtuar	724	3.640	1.545	215	6124	24.4%
AP-aktivitet e pastrimit	2.979	8.127	2.175	48	13330	53%
AH-Aktivitet e hortikultures	2.123	3.363	180	10	5675	22.6%
Totali	5.825	15.130	3.900	273	25129	100%
%	23,2%	60,2%	15,5%	1,1%	100%	

Analiza e kostove të mirëmbajtjes në nivel gjashtëmujor është e përqendruar në pjesën e parë të vitit në vlerë 20.955 euro, e shprehur në përqindje 83,4%.

Ndikimi buxhetor nuk ka ndonjë rol me rëndësi në mbulimin e kostove, sepse pjesa më e madhe e kostove të mirëmbajtjes është në tremujorin e dytë dhe të tretë, e cila nënkupton mundësi të përbushjes së obligimeve financiare nga buxheti komunal i planifikuar.

Tab. 12 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (gjashtëmujore)

Kategoria	Jan-Qershor	Korr-Dhjetor	Totali	%
AN	4346	1761	6124	24.4
AP	11106	2223	13330	53
AH	5486	190	5675	22.6
Totali	20955	4174	25129	100
%	83.4	16.6	100	




Fig. 2 Kostot e mirëmbajtjes në bazë të kategorive

Tab. 13 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (e shprehur në vlerë)

Kategoria	Sheshe	Gjelbërim	Lumenj	Parqe	Varreza të dëshmorëve	Varreza të martirëve	HHP-Pllaka përkujtimore	HHP-Lapidare	Totali
AN -Ambienti i ndërtuar	145	622	-	1.279	1.518	259	1.685	167	5.675
AP - Aktivitetet e pastrimit	2.582	297	706	1.082	659	272	520	5	6.124
AH -Aktivitetet e hortikulturës	6.416	1.749	-	1.423	1.05	785	1.885	23	13.331
Totali	9.143	2.669	706	3.784	3.227	1.316	4.09	196	25.13
Në %	36,4%	10,6%	2,8%	15,1%	12,8%	5,2%	16,3%	0,8%	100%

Tab. 14 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore

Kategoria	Vlera	Vlera në %
Sheshe	9.143	36,4%
Gjelbërime	2.669	10,6%
Lumenj	706	2,8%
Parqe	3.784	15,1%
Varreza të dëshmorëve	3.227	12,8%
Varreza të martirëve	1.316	5,2%
HHP - Pllaka përkujtimore	4.090	16,3%
HHP - Lapidare	196	0,8%
Totali	25.130	100%




Fig. 3 Pjesëmarrja e kategorive të HHP-ve

Tab. 15 Mirëmbajtja në bazë të kategorive kryesore (urbane e rurale)

Kategoria	Urbane	Rurale	Totali
Gjelbërime	2.409	260	2.669
HHP - Lapidare	79	116	196
HHP - Pllaka përkujtimore	1.058	3.033	4.090
Lumenj	-	706	706
Parqe	832	484	1.316
Sheshe	4.502	4.641	9.143
Varreza të dëshmorëve	962	2.821	3.784
Varreza të martirëve	-	3.227	3.227
Totali	9.842	15.288	25.130
Në %	39,2%	60,8%	100%




Fig. 4 Mirëmbajtja-Kostoja sipas vendbanimeve

Tab. 16 Mirëmbajtja në bazë të prioriteteve

Prioriteti	TM1	TM2	TM3	TM4	Totali	Numri i HHP-ve
Prioritet i lartë	2.406	4.351	1.303	199	8.26	31
Prioritet i mesëm	1.127	2.538	590	31	4.286	25
Prioritet i ultë	2.292	8.241	2.007	43	12.583	12
Totali	5.825	15.13	3.9	273	25.129	68

4.2. Kostot e planifikuara të mirëmbajtjes së HHP-ve për periudhën 2016-2021

Kostot e planifikuara të mirëmbajtjes për periudhën e planit janë të bazuara në kostot e vlerësuara për vitin 2016, të cilat janë bazë për projektimin e kostove në periudhën e planit. Norma e rritjes së kostove për periudhën e planit është vlerësuar 3,5% në nivel vjetor, në të cilën përfshihen të gjitha kostot të cilat në periudhën e planit do shënojnë rritje, bazuar në rritjen e nevojës për mirëmbajtje cilësore të HHP-ve.

Tab. 17 Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve për periudhën 2016-2021

Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020
Sheshe	9.143	9.463	9.794	10.137	10.492
HHP - Pllaka përkujtimore	4.09	4.234	4.382	4.535	4.694
Varreza të dëshmorëve	3.784	3.916	4.053	4.195	4.342
Varreza të martirëve	3.227	3.34	3.457	3.577	3.703
Gjelbërime	2.668	2.761	2.858	2.958	3.062
Parqe	1.316	1.362	1.409	1.459	1.51
Lumenj	706	731	756	783	810
HHP - Lapidare	196	202	209	217	224
Totali	25.129	26.008	26.919	27.861	28.836

4.3. Rrjedha e parasë e kostove të mirëmbajtjes

Rrjedha e parasë e HHP-ve është bazuar në aktivitetet e planifikuara të nevojshme për plotësimin e kërkesave për mirëmbajtje. Rrjedha e parasë është e peshuar me buxhetet e aprovuara për këtë kategori të kostove, të cilat janë përlogaritur me metodën e kostove mesatare për aktivitetet e planifikuara të mirëmbajtjes së HHP-ve.

Analiza e rrjedhës së parasë ofron informacion për lëvizjen e kostove të ndikuara nga sezoni i mirëmbajtjes së HHP-ve. Njohja e lëvizjeve të kostove në bazë të kategorive të përcaktuara të HHP-ve mundëson që rrjedha e parasë të planifikohet konform buxheteve të alokuara si dhe ofron mundësinë e monitorimit të kostove të planifikuara.

Tab. 18 Kostot vjetore të mirëmbajtjes së HHP-ve (në muaj)

Kategoria	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Totali
Kosto vjetore e mirëmbajtjes			5.825,2	8.198	3.157,9	3.774,2	1.295	1.585	1.020,1	215,6	54,7	3,2	25.129
Në %	0%	0%	23,2%	32,6%	12,6%	15%	5,2%	6,3%	4,1%	0,9%	0,2%	0,01%	100%




Fig. 5 Rrjedha e parasë për vitin 2016

Tab. 19 Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve (mujore)

Kategoria	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Totali	Në %
Sheshe	-	-	1.374	3.92	1.447	764	999	38	571	30	-	-	9.143	36,4%
HHP - Pllaka përkujtimore	-	-	1.109	890	779	702	78	441	59	27	4	-	4.09	16,3%
Varreza të dëshmorëve	-	-	562	809	523	988	159	440	158	94	50	-	3.784	15,1%
Varreza të martirëve	-	-	928	703	76	1.022	1	425	29	42	1	-	3.227	12,8%
Gjelbërime	-	-	1.332	809	55	135	18	118	182	17	-	3	2.668	10,6%
Parqe	0	-	502	353	150	132	36	115	22	5	-	-	1.316	5,2%
Lumenj	-	-	-	706	-	-	-	-	-	-	-	-	706	2,8%
HHP -Lapi-dare	-	-	18	7	128	31	4	8	-	-	-	-	196	0,8%
Totali	0	-	5.825	8.198	3.158	3.774	1.295	1.585	1.02	216	55	3	25.129	100%
Në %	0%	0%	23,2%	32,6%	12,6%	15%	5,2%	6,3%	4,1%	0,9%	0,2%	0%	100%	

Tab. 20 Mirëmbajtja në bazë të kategorive të HHP-ve sipas tre-mujorëve

Kategoria	TM1	TM2	TM3	TM4	Totali	Në %
Shesh	1.374	6.131	1.608	30	9.143	36,4%
HHP - Pllaka përkujtimore	1.109	2.372	578	31	4.09	16,3%
Varreza të dëshmorëve	562	2.32	758	144	3.784	15,1%
Varreza të martirëve	928	1.801	455	43	3.227	12,8%
Gjelbërime	1.332	999	317	20	2.668	10,6%
Parqe	502	636	173	5	1.316	5,2%
Lumenj	-	706	-	-	706	2,8%
HHP - Lapidare	18	166	12	-	196	0,8%
Totali	5.825	15.13	3.9	273	25.129	100%
Në %	23,2%	60,2%	15,5%	1,1%	100%	

5. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

5.1. Strategjia komunale dhe aktivitetet me komunitetin

Përfshirja e komunitetit, e shoqërisë civile dhe e publikut në përmirësimin e menaxhimit me HHP në përgjithësi është e rëndësishme dhe ndikimi i pjesëmarrësve është me interes të përgjithshëm në ruajtjen dhe promovimin e HHP-ve. Ato të gjitha e njohin dhe e dallojnë rëndësinë që kanë HHP-të për identitetin lokal dhe mirëqenien qytetare.

Është e njohur mirë rëndësia e procesit të lidhjes së energjisë tek bimët, e quajtur fotosintezë, gjatë të cilit absorbohet dioksidi i karbonit (CO₂) dhe lirohet oksigjeni (O₂). Efektet e këtij procesi në balancimin e ndotjes mund t'i rikujtohen qytetarëve nëpërmjet fletëpalosjeve me porosi simbolike dhe figurative, nëpërmjet aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore të organizuara me fëmijë të shkollave të ulëta por edhe me të rinj të tjerë, në shkolla të mesme, në institucione parashkollore, në ambiente të hapura, etj.

Në këtë kontekst, drejtorit gjegjëse në institucionin komunal, bashkë me komunitetin dhe me shoqatat e përmendura mund të planifikojnë ngjarje të ndryshme kulturore në data të caktuara, si: Dita e Pranverës, Dita e Tokës, etj., të cilat do t'i përkujtonin njohuritë themelore dhe do të nxisnin vëmendjen tek publiku lidhur me mjedisin në të cilin qytetarët kalojnë kohën e tyre të çmueshme.

